




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Nr. 890/27  
Data: 13.08.24

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU  
ENERGY REGULATORY OFFICE



Prishtinë, 07 gusht 2024  
Kodi i ZRRE-së: V\_2312\_2024

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084); Nenin 9 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së; Nenin 3, 4, 5 dhe 7 të Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtitshme të nxjerr nga Bordi i ZRRE-së, dhe Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej **4 kW**, e pranuar me datë 06.08.2024 nga aplikuesi "Izaim Latifi", me adresë: Rr. "Rrezja, Magure" Komuna e Lipjanit, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur më 07 gusht 2024 nxori këtë:

## V E N D I M

### PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. **APROVOHET** - kërkesa dhe miratohet Statusi i Prosumatorit aplikuesit "Izaim Latifi" për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej **4 kW** në Komunën e Lipjanit.
- II. **OBLIGOHET** – aplikuesi "Izaim Latifi" me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DFE – 54391 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtoj kërkesë në KEDS SH.A., për pranimit teknik të objektit energjetik.
- III. ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV. Aplikuesi "Izaim Latifi" do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me Nenin 7 paragrafi 5 dhe 6 i Rregullës Nr. 03/2023 për Vet-Konsumatorët me Burime të Ripërtitshme.

## A r s y e t i m

- o ZRRE, me datë 06.08.2024 nga aplikuesi "Izaim Latifi" ka pranuar aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **4 kW** në Komunën e Lipjanit.
- o Aplikuesi, s'bashku me aplikacionin ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetor të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të




instaluar dhe pëlqimin elektroenergetik Nr. 10357 të datës 30.07.2024 të lëshuar nga KEDS SH.A.

- o Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "Izaim Latifi" dhe dëshmive të bashkangjitura, për marrjen e statusit të prosumtorti dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike, me kapacitet të instaluar prej **4 kW** në Komunën e Lipjanit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

~~Bordi i ZRRE-së:~~

  
\_\_\_\_\_  
Ymer Fejzullahu, Kryesues

  
\_\_\_\_\_  
Lutfije Dervishi, Anëtare

  
\_\_\_\_\_  
Gani Buçaj, Anëtar

  
\_\_\_\_\_  
Arta Isufi, Anëtare

  
\_\_\_\_\_  
Adnan Preniqi, Anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- KEDS SH.A.,
- KESCO dhe
- Arkivit të ZRRE-së.